



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:199311
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05756733

CAP.nr.1053/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores së përmbarimit Raiffeisen Bank - Prishtinë, kundër debitorëve të përmbarimit A.LL nga Gj,,,, rr.”,,,” p.nr, dhe B.Zh nga Gj,,,, rr.”,,,” nr,,,” për shkak të përmbarimit të dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores së dytë të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.129/22, të datës 22.06.2023, me datën **29.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitores së dytë B.Zh nga Gj,,,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.129/22, i datës 22.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar, PPP.nr.129/22, të datës 22.06.2023, e ka hedhur si të pa afatshme ankesën e debitores B.Zh nga Gj,,,, të parashtruar me datën 23.09.2022 kundër parregullive me rastin e kryerjes së përmbarimit në lëndën përmbarimore P.nr.299/17, më gjërësisht si në aktvendimin e atakuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitorja e dytë i, për shkak të *shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore*, vërtetimit të *gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të arovohet ankesa dhe aktvendimi i atakuar të anulohet dhe t aprovohet kundër parregullive me rastin e kryerjes së përmbarimit

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbaremit Raiffeisen Bank - Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbare kundër debitorëve të përmbaremit A.LL dhe B.Zh, të dy nga Gj,,, ndërsa përmbareusi privat me urdhërin përmbareimor P.nr.299/17, të datë s10.10.2017 ka lejuar përmbareimin ndaj debitorëve të lartcekur për pagimin e borxhit, të paraparë më gjërisisht si në dokumentin përmbareimor.

Kundër urdhërit për përmbare debitorët e lartcekurnuk kanë paraqitur prapësim.

Me datën 23.09.2022 debitorja e dytë B.Zh ka paraqitur ankesë kundër parregullsisve me rastin e kryerjes së përmbareimit nga ana e përmbareusit privat. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me ankesën ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.129/22, të datës 22.06.2023, e ka hedhur si të pa afatshme ankesën e debitorës B.Zh nga Gj,,, të parashtruar me datën 23.09.2022 kundër parregullsisve me rastin e kryerjes së përmbareimit në lëndën përmbareimore P.nr.299/17. Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se urdhërin përmbareimor debitorja e ka pranuar me datën 03.11.2017, ndërsa ankesën kundër parregullsisve me rastin e kryerjes së përmbareimit e ka parashtruar me datën 23.09.2022 jashtë afatit të paraparë ligjor 7 ditë nga shkelja e pretenduar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të debitorës Gjykata e Apelit i konsideron të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që me dispozitat ligjore në fuqi lidhur me ankesën kundër parregullsisve me rastin e kryerjes së përmbareimit, përkatësisht me nenin 79 par.1 të LPP-së shprehimisht parashihet se *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbareues gjatë kryerjes së procedurës së përmbareimit.*

Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrësë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar”.

Në rastin konkret, sipas shkresave të lëndës nuk është kontestues fakti se pala debitore urdhërin përbarimor P.nr.299/17, të datës 10.10.2017, me të cilin është lejuar përbarimi, e ka pranuar me datën 03.11.2017 (*e cila konstatohet nga fletë-dërgesa në shkresat e lëndës*), ndërsa ankesën kundër parregullsisë e ka dorëzuar në gjykatë me datën 23.09.2022, andaj gjykatës i rezultoi se debitori ankesën e ka parashtruar pas kalimit të afatit ligjor prej 7 ditësh. Kjo për faktin se në rastin konkret afati ka filluar të llogaritet nga data 04.11.2017 (*dita e parë pas ditës së pranimit të urdhërit-ditë pune*), ndërsa kur llogariten 7 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 10.11.2017-ditë pune, ndërsa debitorja ankesë e ka paraqitur me datë 23.09.2022, që rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej gati 5 viteve, andaj dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për hudhjen e ankesës si të pa afatshme është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata e Apelit, pretendimet ankimore të debitores se *gjykata së shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh faktet e rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, dhe e ka shkelë të drejtën ligjore të debitores së përbarimit*, i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se siç u cek edhe më lartë, duke iu referuar fletë-dërgesës për pranimin e urdhërit në fjalë, rezulton se pala debitore të njëjtin e ka pranuar me datën 03.11.2017 (*e cila datë është shënuar edhe nga ana e vet marrësit - debitorës, e edhe nga ana e dorëzuesit*), ndërsa që ankesën e ka dorëzuar me datën 23.09.2022, që do të thotë se e njëjta është dorëzuar jashtë afatit të paraparë ligjor prej 7 ditësh, i cili afat është afat prekluziv, ndërsa që gjykata fare nuk është marrë dhe nuk ka mundur të mirret me pretendimet dhe faktet e cekura në ankesë, për shkak të parashtrimit të pa afatshëm të saj.

Si përfundim, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është hedhur poshtë prapësimi si i pa afatshëm është i drejtë dhe i ligjshëm, e i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 186.2 LPK-së, dhe nenit 73.3 të LPP-së, ashtu që pretendimet ankimore të debitorit janë të pabazuara dhe të pargumentuara me asgjë, andaj dhe i njëjti aktvendim - vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208, 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1053/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj